

VLERËSIMI PARANDALUES PËR KORRUPSION I PROJEKTLIGJIT

“Për Disa Shtesa Dhe Ndryshime Në Ligjin Nr. 58/ 2022 “Për Krijimin, Organizimin Dhe Funksonimin E Parqeve Teknologjike Dhe Shkencore”

1

ÇFARË ËSHTË “VLERËSIMI PARANDALUES PËR KORRUPSION”?

Vlerësimi Parandalues për Korrupsion është një proces që:

- Analizon projektligjet për të identifikuar rreziqet potenciale të korrupsionit.
- Synon që legjislacioni të jetë transparent, i drejtë dhe i zbatueshëm pa hapësira abuzimi.
- Siguron që ligjet të mos krijojnë avantazhe të padrejta për aktorë privatë apo të çenojnë interesin publik.
- Nxit llogaridhënie dhe transparencë në procesin ligjvënës.
- Mbështet institucionet dhe shoqërinë civile në forcimin e integritetit publik.

2

VLERËSIMI PARANDALUES PËR KORRUPSION PËRFSHIN:

- Vlerësimin e transparencës dhe konsultimit publik.
- Analizën e qëllimeve të deklaruara dhe reale të ligjit.
- Ekzaminimin e përfitimeve publike dhe private.
- Kontrollin e përshtatshmërisë së argumentimit ligjor.
- Analizën e ndikimeve financiare.

3

KONTEKSTI

Projektligji synon krijimin e një sistemi të përgjegjësive të zgjeruara të prodhuesve për produktet që gjenerojnë mbetje: një hap drejt ekonomisë qarkulluese dhe mbrojtjes së mjedisit.

Përmbledhja e opinionit mbi projektligjin

4

GJETJET KRYESORE



TRANSPARENCA DHE KONSULTIMI PUBLIK

- Relacioni shoqërues jo i plotë; nuk përmban të dhëna mbi zbatimin e ligjit ekzistues dhe ndikimet ekonomike.
- Projektligji dhe relacioni nuk i janë nënshtruar asnjë konsultimi publik dhe nuk ka opinione nga palët e interesuara.
- Efektet financiare të pritshme nuk janë analizuar, megjithëse ligji ka ndikim fiskal.



QËLLIMET DHE MOTIVET E LIGJIT

- Qëllimet e shpallura të projektligjit tashmë mbulohen nga ligji bazë nr. 58/2022.
- Projektligji fsheh qëllime të padeklaruara, si përfshirja e veprimtarisë virtuale, lehtësimi i shitblerjes së aksioneve dhe përjashtimi nga TVSH-ja.



INTERESAT PUBLIKE DHE PRIVATE

- Relacioni nuk sqaron mbrojtjen e interesave publike kundrejt interesave private.
- Rreziqet kryesore: evazion fiskal, abuzim dhe shkelje e konkurrencës.
- Marrëveshjet jo transparente mes përdoruesve/zhvilluesve dhe enteve publike mund të favorizojnë interesat private.



PËRSHTATSHMËRIA E NISMËS

- Nuk ka të dhëna mbi numrin e parqeve, përdoruesit, problemet e shfaqura dhe ndikimin ekonomik të tyre.
- Argumentimi i nismës është i përgjithshëm dhe nuk justifikon nevojën për ndryshime ligjore.



IMPLIKIMET FINANCIARE

- Relacioni deklaron gabimisht se projektligji nuk ka efekte financiare.
- Ndërkohë projektligji ka efekte financiare, pasi zgjeron lehtësitë fiskale dhe tarifatat që zbaton zhvilluesi të përdoruesit, si dhe përfshirjen e enteve publike në veprimtari të tilla.